



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 477/5 prot.

Tiranë, më 6.1.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Erion Pano
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 23.12.2022, është njoftuar vendimi nr. 592, datë 24.11.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Erion Pano, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Erion Pano, prej vitit 2005 ushtron detyrën e prokurorit, aktualisht i komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1, të aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin, z. Erion Pano, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve: atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Erion Pano<sup>1</sup>”, ka referuar për subjektin, se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Erion \*\*\* Pano”.

2.3 KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Pano, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurorë, krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në Deklaratën “Vetting” dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaramet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit [...]².

4. **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e përgatitur nga DSIK-ja, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] arrin nivel të besueshëm në

<sup>1</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.4.2018.

<sup>2</sup> Për më tepër referohuni në f. 44, të vendimit të Komisionit.

*kontrollin e figurës... pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar [...].<sup>3</sup>*

**5. Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, burimet arkivore dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se: *[...] nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e prokurorit E. Pano dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë” [...].<sup>4</sup>*

**6. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Erion Pano, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**7.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**8.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

**9.** Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

**10.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

**11.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 592/2022 të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim

<sup>3</sup> Për më tepër referohuni në f. 45, të vendimit.

<sup>4</sup> Për më tepër referohuni në f. 54, të vendimit.

është i cenushtëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**12.** Sa më sipër, bazuar në kërkesat e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, konstatohet se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të drejta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara.

**13.** Për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### **III.A. Për kontrollin e pasurisë**

**14.** Për sa i takon rivlerësimin të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimin, objekti i hetimit dhe i vlerësimin të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimin duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**15.** Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektin të rivlerësimin i janë kërkuar shpjegime dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar problematika mbi saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të subjektin të rivlerësimin dhe personave të lidhur me të.

**16.** Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimin dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në "*Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie*", për vitin 2003<sup>5</sup>, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën "Vetting" (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën \*.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

#### **17. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 92,8 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë**

17.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimin ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 83 m<sup>2</sup> dhe sip. e përbashkët 9,8 m<sup>2</sup>, adresa rruga "\*\*\*\* \*\*", shk. \*\*, ap. \*\*, \*\*\*, Tiranë, nr. Regjistri hipotekor \*\*\*, datë \*.10.2011. Realizuar me kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*/\*\* kol., datë \*.10.2011, me palë shitëse "\*\*\*\*-\*\*\* Konstruksion" dhe blerës Erion Pano. *Vlera*: 61.000 euro. *Pjesa takuese*: 50%.

Burimi i krijimit: (i) Huamarrje 3.000.000 lekë, realizuar me kontratën e huamarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*.9.2011. Shuma e detyrimit financiar prej 3.000.000 lekë i është shlyer

---

<sup>5</sup> Deklaruar në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

huadhënësit ndër vite dhe e plotë në datën \*\*.10.2006, si dhe evidentohet në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*/\*\*\* kol. (bashkëlidhur dokumentet); **(ii)** Kontratë huamarrje nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2008, shuma 10.000 euro. Shuma e detyrimit financiar prej 10.000 euro i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë në datën \*\*.12.2014, si dhe evidentohet në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\*/\*\* kol., (bashkëlidhur dokumentet); **(iii)** Duke vijuar është përdorur shuma prej 1.900.000 lekë të bonove të Thesarit (në emër të Erion Pano) në Bankën e Shqipërisë, me burim: *kursimet e mia e të bashkëshortes nga puna ndër vite, të cilën e kam tërhequr të plotë në datën \*\*.6.2008*; **(iv)** Shuma prej 848.947 lekë bono thesari (në emër të \*\*\* \*\*\*) në Bankën e Shqipërisë, me burim: *kursimet e mia e të bashkëshortes nga puna ndër vite, tërhequr datë 24.2.2011* (bashkëlidhur dokumentet); Gjithashtu në blerjen e apartamentit janë përdorur interesat e bonove të Thesarit, gjendja *cash* në banesë, akumuluar ndër vite nga pagat e mia dhe të bashkëshortes.

17.2 Në DV-2010, subjekti deklaron: Apartament banimi 92,8 m<sup>2</sup>, adresa rruga “\*\*\*\* \*\*”, kati \*\*, nr. \*\*, \*\*, Tiranë. Kontratë porosie për ndërtim dhe dorëzim apartamenti me palë sipërmarrëse “\*\*\*\*-\*\*\* Konstruksion” dhe porositës \*\*\* \*\*\*, datë \*\*.3.2010. Vlera në total 61.000 euro, me afat likuidimi datë \*\*\*.3.2012. Shuma e paguar rezultat i të ardhurave nga pagat vjetore që prej fillimit të punës (deklaruesi dhe bashkëshortja), huamarrje dhe kredi. Pagar 25.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti ka deklaruar: **(i)** Kontratë kredie dhe hipotekimi \*\*\* Bank, 400.000 lekë principal + interes 94.400 lekë. Kësti mujor 16.700 lekë. Data e fillimit \*\*.12.2008, e mbarimit \*\*.6.2011. Pjesa e detyrimit të shlyer 199.199 lekë dhe detyrimi i mbetur 98.401 lekë; **(ii)** Kontratë huamarrje nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2008, shuma 10.000 euro. Afati i shlyerjes \*\*.12.2010. Shtyrë me marrëveshje mes palëve me afat përfundimtar shlyerje datë \*\*.9.2011. Huadhënësi \*\*\* \*\*. *Nuk është deklaruar shuma e shlyer dhe detyrimi i mbetur.* **(iii)** kontratë porosie për ndërtim dhe dorëzim apartamenti me palë sipërmarrëse “\*\*\*\*-\*\*\* Konstruksion” dhe porositës \*\*\* \*\*\*, datë \*\*.3.2010. Vlera totale e apartamentit 61.000 euro. Data e fillimit të pagesës \*\*.3.2010, e likuidimit datë \*\*.3.2012. Shuma e shlyer 25.000 euro. Detyrim i mbetur 35.000 euro.

17.3 Në DV-2011, subjekti deklaron: Apartament banimi 83 m<sup>2</sup> (sip. e përbashkët 9,8 m<sup>2</sup>), adresa rruga “\*\*\*\* \*\*”, kati \*\*, \*\*, Tiranë, nr. Regjistri hipotekor \*\*\*, datë \*\*.10.2011. Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*/\*\* kol., datë \*\*.10.2011, me palë shitëse “\*\*\*\*-\*\*\* Konstruksion” dhe blerës Erion Pano. Shuma e paguar rezultat i të ardhurave nga pagat vjetore që prej fillimit të punës (deklaruesi dhe bashkëshortja), huamarrje, qiramarrje dhe kredi. Pagar 36.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: Kontratë huamarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.2011, me palë huadhënëse \*\*\* \*\*\* dhe huamarrës Erion Pano, shuma 3.000.000 lekë. Afati i kontratës së huas fillon më datë \*\*.9.2011 deri në \*\*.9.2018, data e likuidimit total.

17.4 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.8.2020, konfirmon pasurinë “apartament” me sip. 83 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*/\*\*\*+\*\*-\*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në Tiranë, në pronësi të z. Erion Pano, blerë përmes kontratës së

shitblerjes me nr. \*\*\*/\*\*\*/\*\*, datë \*\*.10.2011, përkundrejt çmimit 61.000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale.

**18.** Në vlerësim të saktësisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, nga hetimi administrativ i Komisionit kanë rezultuar faktet si më poshtë:

18.1 Origjina e pronësisë për apartamentin me sip. 92.8 m<sup>2</sup>, vjen nga kontrata e porosisë së datës \*\*.3.2010, nënshkruar midis personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes, znj. \*\*\*. \*\*\*, dhe shoqërisë sipërmarrëse “\*\*\*-\*\*\* Konstruksion” sh.p.k., akt ky i paraqitur gjatë hetimit administrativ. Kjo marrëdhënie është finalizuar me lidhjen e kontratës së shitblerjes me nr. \*\*\*/\*\*\*/\*\*, datë \*\*.10.2011, nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë sipërmarrëse. Pagesat për apartamentin janë kryer nga bashkëshortja e subjektit pranë shoqërisë “\*\*\*-\*\*\* Konstruksion” sh.p.k., nëpërmjet: (i) mandatpagesës nr. \*\*, datë \*\*.3.2010, për shumën 25.000 euro dhe (ii) mandatpagesës nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2011, për shumën 36.000 euro.

18.2 Lidhur me *burimet e krijimit të pasurisë*, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se si burim ***për këstin e parë me shumë 25.000 euro***, paguar në datën \*\*.3.2010, janë përdorur: (i) hua në shumën 10.000 euro, marrë shtetasit \*\*\*. \*\*\*, dhe (ii) shuma 15.000 euro nga paratë e tërhequra në datën \*\*\*.6.2008, të investuara në bono thesari, në emrin e tij, në shumën 1.900.000 lekë (e konvertuar në muajin gusht të vitit 2008 me kursin e kohës 122 lekë), me burim, kursimet nga puna e subjektit dhe bashkëshortes, prej vitit 2001 deri në vitin 2007. ***Për këstin e dytë, me vlerë 36.000 euro***, paguar në datën \*\*.10.2011, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer: (i) huaja në shumën 3.000.000 lekë, marrë nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*. (e konvertuar me kursin e kohës 141 lekë, ku vlera e konvertuar ishte rreth 21.000 euro); (ii) shuma 842.063 lekë, bono thesari në emër të bashkëshortes, e tërhequr në datën 24.2.2011 (e konvertuar në muajin gusht me kursin e këmbimit rreth 140 lekë, ku vlera e konvertuar është 6.000 euro), me burim kursimet e subjektit dhe bashkëshortes, nga puna për periudhën 2001 – 2010 dhe (iii) diferenca prej 9.000 euro, ka si burim një pjesë të kursimeve *cash*, të akumuluar nga puna e subjektit dhe bashkëshortes, për periudhën 2001 – 2011, ku sasia e parave e konvertuar me kursin e kohës ishte 1.250.000 lekë.

18.3 Në përfundim të hetimit administrativ, rezulton se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka konstatuar se:

(i) *Ka mospërputhje deklarimesh të kursimeve cash në deklaramet periodike ndër vite, me shpjegimet e subjektit gjatë hetimit, si dhe shpjegimet sipas procesverbaleve të mbajtura pranë ILDKPKI, të cilat kanë krijuar balancë negative për vitet 2009 – 2011, në vlerë totale - 3.834.458 lekë;*

(ii) *Subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e bonove të thesarit dhe shtesën e likuiditeteve cash (nga tërheqja e bonove), në deklaramet periodike ndër vite (2008-2010), të përdorura për blerje apartamentit në vitet 2010 dhe 2011;*

(iii) *Duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e bonove të thesarit, duke rezultuar me një balance negative në shumën totale - 590.986 lekë, për vitin 2005 dhe 2006.*

18.4 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se është i vetëdijshëm mbi pasaktësitë në deklaramin e gjendjeve *cash* deri në vitin 2011, por këto pasaktësi i ka

korrigjuar/saktësuar gjatë këtij procesi administrativ, të cilat kanë ardhur si pasojë e perceptimit të gabuar në mënyrën e plotësimit të deklaratave ndër vite, mungesa e eksperiencës, trajnimeve të duhura, si dhe mungesa e vëmendjes dhe dhënies së rëndësisë së duhur në plotësimin e tyre, duke deklaruar në mënyrë të detajuar kursimet ndër vite për periudhën deri në vitin 2011<sup>6</sup>.

18.5 Komisioni, pasi ka vlerësuar provat dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se rezulton i provuar investimi i kryer nga subjekti në bono thesari me shumë 1.900.000 lekë nga viti 2003 deri në vitin 2007, si dhe tërheqja e kësaj shume në vlerën 1.797.500 lekë në datën \*\*.8.2008. Sa i përket shpjegimeve të subjektit se mosdeklarimi i pakësimit të bonove të thesarit dhe shtesa e likuiditeteve *cash* (nga tërheqja e bonove dhe huaja e marrë nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*.), në deklaratimet periodike në vite ka ardhur, pikërisht, si pasojë e perceptimit të gabuar të tij, pasi duke deklaruar huan dhe investimet në bono thesari kishte përmbushur detyrimin për deklarim, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse, në kushtet kur këto likuiditete burojnë nga kursimet familjare ndër vite të dokumentuara, si dhe nga një marrëdhënie e ligjshme huamarrjeje. Gjatë periudhës 2008 – 2010, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar pasuri të tjera të asnjë lloji apo të ketë kryer shpenzime që do të justifikonin ndryshimin e destinacionit të përdorimit të shumave të disponuara në gjendje *cash*. Në vlerësim të deklaratimeve dhe fakteve sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se, pavarësisht se nuk është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar që kjo pasaktësi në deklarim të kursimeve *cash* të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri apo të ketë shërbyer si shkak apo burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër nga subjekti.

18.6 Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka rishikuar analizën financiare, duke marrë në konsideratë kursimet *cash* të saktësuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e apartamentit për periudhën 2001 – 2011, referuar tabelës së përgjithshme, do të rezultonte me një balancë negative në shumën totale prej - 117.163 lekësh, vetëm për vitin 2006. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se pamjaftueshmëria financiare e rezultuar është në një masë të tillë që nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**19. Komisioneri Publik**, në analizë të akteve të administruara, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i situatës faktike të kryer nga Komisioni dhe përfundimet e arritura prej tij lidhur me burimet e krijimit të pasurisë *apartament*. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, duke analizuar si më poshtë:

19.1 Vlen të theksohet se, kur si burim për krijimin e një pasurie deklarohen prej subjekteve të rivlerësimit kursime të poseduara në *cash*, nisur për nga natyra e tyre, Kolegji ka orientuar Komisionin të llogarisë këto kursime sikundër deklarohen në deklaratat periodike vjetore, të cilat në kuadër të këtij procesi marrin vlerën e provës<sup>7</sup>. Vlerësimi i Komisionit dhe rishikimi i

<sup>6</sup> Për më tepër referohuni shpjegimeve të subjektit në përgjigje të barrës së provës.

<sup>7</sup> Për më tepër referohuni vendimit (JR) nr. 11/2019 etj.

analizës financiare, duke marrë në konsideratë kursimet *cash* të saktësuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të barrës së provës, duket se nuk mbështetet në praktikën e konsoliduar gjyqësore të Kolegjit. Për më tepër rezulton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, gjatë procesit të hetimit administrativ<sup>8</sup>, krahasuar me deklaratimet e dhëna në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së<sup>9</sup>, mbi të cilat Komisioni ka bazuar dhe vendimmarrjen e tij, janë kontradiktore dhe të pasakta, duke e pamundësuar kështu gjurmimin dhe përlllogaritjen e saktë të tyre, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të krijuar për përdorura për pasurinë “*apartament me sip. 92.8 m<sup>2</sup>*”.

19.2 Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DV-2008 tërheqjen e shumës prej rreth 1.797.500 lekë<sup>10</sup>, me burim investimin në bono thesari, si dhe posedimin e kësaj shume *cash* në banesë. Subjekti nuk rezulton të ketë saktësuar as në deklaratimet e mëvonshme, në DV-2009 - 2010, ekzistencën dhe përdorimin e kësaj shume për blerje apartamenti, sikundër duket se ka bërë për shumën 10.000 euro, marrë hua shtetasit \*\*\*.\*\*\*., shumë të cilën e ka rideklaruar si një nga burimet e blerjes së pasurisë *apartament*, në DV-2010. Përkundrazi, subjekti në DV-2010, si një ndër burimet e blerjes së pasurisë *apartament banimi* ka deklaruar dhe “kredi”, e cila, bazuar në aktet në dosje, duket se i referohet të vetmes kredi që subjekti rezulton të ketë marrë pranë \*\*\* Bank në vitin 2008, përdorimin e së cilës, referuar deklaratës vjetore DV-2008 dhe deklaratimit të subjektit gjatë hetimit administrativ, ka shërbyer për rinovim banese dhe blerje pajisje shtëpiake për apartamentin që kishte në përdorim.

19.3 Sa më sipër, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>11</sup>, Komisioneri Publik vlerëson se burimi i deklaruar: “*të ardhura nga bono thesari të tërhequra nga llogaria bankare në gusht 2008*”, për sa kohë nuk është deklaruar posedimi i tyre në *cash* nga ana e subjektit në vitet 2008-2009, dhe as i deklaruar saktësisht si një nga burimet e pagesës së kështit të parë të pasurisë *apartament banimi*, nuk mund të konsiderohet në mesin e burimeve të ligjshme të krijuar të shumës 25.000 euro, paguar në muajin mars 2010.

19.4 Komisioneri Publik konsideron të pabazuar edhe konstatimin e Komisionit për mbulimin me burime të ligjshme të kursimeve dhe shpenzimeve për periudhën 2003-2007, periudhë gjatë së cilës janë krijuar investimet në bono thesari si më sipër. Rezulton se Komisioni, gjatë trajtimit dhe analizimit të burimeve të ligjshme të mbulimit të shpenzimeve dhe krijuar të kursimeve, ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ rreth kursimeve të deklaruara, të cilat bien në kundërshtim, si me deklaratimet e kursimeve në deklaratat vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, ashtu dhe me sqarimet e dhëna pranë këtij institucioni, referuar procesverbalit të vitit 2013 dhe 2016. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, konstatohet se:

- Në DV-2003, në rubrikën ku kërkohet të deklarohen likuiditetet, subjekti ka deklaruar: *bono thesari 0.5 milionë lekë, Banka e Shtetit Shqiptar, burimi të ardhura nga paga dhe të dhuruara nga familja.*

<sup>8</sup> Për më tepër referohuni në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në Pyetësorin nr. 2 dhe në rezultatet e hetimit administrativ.

<sup>9</sup> Procesverbalet të mbajtura në vitet 2013 dhe 2016.

<sup>10</sup> Në Deklaratën “Vetting”, subjekti deklaroi si shumë vlerën 1.900.000 lekë.

<sup>11</sup> Për më tepër referohuni në vendimin (JR) [nr. 13/2021](#), prg. 54-55 dhe vendimin [nr. 35/2021](#), prg. 16.8.



- Në DV-2004, subjekti ka deklaruar vetëm të ardhurat nga pagat, si dhe interesat nga investimi në bono thesari pa deklaruar kursime.
- Në DV-2005, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar, bono thesari, Banka e Shqipërisë, viti 2005, kursime familjare, shuma 300.000 lekë<sup>12</sup>. Në të njëjtën deklaratë, në faqen nr. 8 të saj, në seksionin: “të dhëna që nuk publikohen”, subjekti ka deklaruar: 400.000 lekë, kursime familjare nga pagat vjetore.
- Në DV-2006, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: (i) kursime në para (nga paga) 700.000 lekë, pjesa takuese 60%; (ii) kursime nga paga për vitin 2005, të depozituara në bono thesari, Banka e Shqipërisë, shuma 400.000 lekë, pjesa takuese 60%; (iii) kursime nga paga depozituar në bono thesari, Banka e Shqipërisë (bashkëshortja), shuma 300.000 lekë, pjesa takuese 40%.
- Në DV-2007, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: (i) Erion Pano, kursime nga paga viti 2007, shuma 492.019 lekë, pjesa takuese 60%; (ii) \*\*\* \*\*\*, kursime nga paga viti 2007, shuma 3628.186 lekë, pjesa takuese 40%; (iii) blerje bono thesari, Banka e Shqipërisë, datë maturimi 19.6.2007, shuma 700.000 lekë.
- Në DV-2008, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: Erion Pano, kursime nga paga viti 2008, shuma 450.000 lekë, pjesa takuese 60%; (ii) \*\*\* \*\*\*, kursime nga paga vjetore 2008, shuma 350.000 lekë, pjesa takuese 40%.

19.5 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi saktësimin e kursimeve cash ndër vite, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2 dhe rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si më poshtë:

- Në DV-2005, në rubrikën: “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e luajtshme e të paluajtshme”, kam deklaruar bono thesari në shumën 300.000 lekë, me burim kursime familjare dhe në rubrikën: “të dhëna që nuk publikohen”, kam deklaruar 400.000 lekë, kursime familjare nga pagat vjetore. Me kursime familjare kam pasur parasysh kursimet në total, të cilat kanë qenë 300.000 lekë në bono thesari dhe afërsisht 100.000 lekë në llogarinë time në bankën \*\*\*.
- Në DV-2006, në rubrikën: “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e luajtshme e të paluajtshme”, kam deklaruar kursime në para nga paga 700.000 lekë, kursime nga paga të depozituara në bono thesari 400.000 lekë, kursime nga paga (bashkëshortja) depozituar në bono thesari, në shumën 300.000 lekë. Dhe në këtë vit, të gjitha kursimet tona të vitit janë depozituar në sistemin bankar. Gjendja cash 0 lekë<sup>13</sup>.
- Në DV-2007, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, kam deklaruar kursime të miat nga paga, viti 2007, në shumën 492.019 lekë, kursime të bashkëshortes, në shumën 328.186 lekë, blerje bono thesari në shumën 700.000

<sup>12</sup> Investimet në bono thesari konfirmohen nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. \*\*\*/\*\*, datë \*\*/7.2020.

<sup>13</sup> Përveç rishikimit të kursimeve në cash, subjekti ka pretenduar edhe rishikimin e të ardhurave të bashkëshortes dhe shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2006, rillogaritur në vlerën totale rreth 500 euro.

lekë. Gjendja *cash* në këtë vit ka qenë afërsisht 120.000 lekë (492.019 lekë + 328.186 lekë - 700.000 lekë bono).

- Në *DV-2008*, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kam deklaruar kursime të miat dhe të bashkëshortes në shumën 450.000 lekë dhe 350.000 lekë. Pra, në total 800.000 lekë. Në këtë vit nuk kemi pasur shtesa në sistemin bankar. Kjo shumë i është shtuar gjendjes *cash* të vitit 2007. Pra, në total në vitin 2008, kemi pasur 920.000 lekë (120.000 lekë + 800.000 lekë) nga kursimet e vitit 2007 dhe 2008, si dhe 1.797.500 lekë tërhequr nga bonot e thesarit (pas kalimit në \*\*\* Bank, kjo shumë është tërhequr *cash*), dhe 10.000 euro të deklaruar në rubrikën: “detyrimet financiare”, të marra hua nga \*\*\*, \*\*\*.
- Në *DV-2009*, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” kam deklaruar: “kursime nga paga, Erion Pano, viti 2009, vlerën 400.000 lekë, 50%” dhe “kursime nga paga, \*\*\* \*\*\*, 400.000 lekë, 50%”. Në fund të vitit 2009, kemi pasur gjithsej në *cash* 1.320.000 lekë nga kursimet e viteve 2007, 2008 dhe 2009, si dhe 10.000 euro nga huaja dhe 1.797.500 lekë nga bonot e thesarit.
- Në *DV-2010*, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” kam deklaruar: “kursime nga paga Erion Pano, viti 2010, 320.000 lekë, 50 %” dhe “kursime nga paga \*\*\* \*\*\*, viti 2010, 320.000 lekë, 50%”. Deri në momentin e pagesës së këstit të apartamentit në shumën 25.000 euro (mars 2010), kemi pasur nga kursimet *cash* të viteve 2007, 2008, 2009 shumën 1.320.000 lekë, shumën 10.000 euro të marrë hua dhe lekët e tërhequra *cash* nga bonot e thesarit, 1.797.500 lekë. Pas pagesës së këstit të apartamentit në shumën 25.000 euro, shuma e mbetur *cash* në fund të vitit 2010, ka qenë afërsisht 1.355.000 lekë<sup>14</sup>.

19.6 Nisur nga sa më sipër deklaruar, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimi i subjektit mbi “*perceptimin e gabuar në mënyrën e plotësimit të deklaratave ndër vite*”, nuk qëndron, sepse nga mënyra e plotësimit të këtyre deklarimeve, duket se subjekti ka pasur të qartë mënyrën e deklarimit të kursimeve, duke specifikuar për çdo rast kur kursimet vjetore janë depozituar në sistemin bankar, në Bankën e Shqipërisë.

19.7 Komisioneri Publik, në këtë vlerësim, mban në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit lidhur me deklarimin e kursimeve apo likuiditeteve *cash*, të cilat duhet të lexohen dhe llogariten ashtu sikurse janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore. Kolegji, ndër të tjera, në vendimin (JR) nr. 11/2022, shprehet se: [...] 33.12 ... *Ky konkluzion mbështetet jo vetëm në mospërputhjet e identifikuarra më sipër, por edhe në konsideratë të rëndësisë provuese të deklaratave periodike vjetore sa i përket gjendjes së cash-it jashtë sistemit bankar, sipas dispozitave të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që ka gjetur trajtim gjerësisht në një sërë*

---

<sup>14</sup> Subjekti ka saktësuar dhe kursimet në vijim, konkretisht: *Në vitin 2011* të gjitha kursimet e mbetura në fund të vitit 2010, si dhe kursimet e vitit 2011 janë përdorur për pagesën e këstit të mbetur të apartamentit. Gjendja *cash* në fund të vitit 2011 ka qenë 50.000 lekë; *Në vitin 2012* nuk kemi pasur kursime në *cash*, por gjendje është 50.000 lekë (mbartur nga kursimet *cash* viti 2011); *Në vitin 2013* kam deklaruar kursimet në sistemin bankar, por gjendje është 50.000 lekë (mbartur nga kursimet *cash* viti 2011); *Në vitin 2014* gjendje është 50.000 lekë (mbartur nga kursimet *cash* viti 2011); *Në DV-2015*, në rubrikën “ndryshimet e pasurive”, kam deklaruar kursime nga paga dhe qiramarrje në shumën 500.000 lekë, të mbajtur *cash* në banesë. Pra, në fund të vitit 2015, gjendja *cash* në banesë ka qenë 500.000 lekë edhe 50.000 lekë (mbartur nga kursimet *cash* viti 2011).

çështjesh të gjykuara nga Kolegji<sup>15</sup>. Sikurse u trajtua edhe në paragrafët e mësipërm, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, neni 4, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte saktësisht gjendjen financiare të likuiditeteve, pas tërheqjes së tyre nga banka. E njëjta frymë përshkruhet edhe në udhëzimet e formularit për plotësimin e deklaratës periodike. Në këtë dokument, në rubrikën: “deklarimi i interesave privatë, pasuri të paluajtshme/të luajtshme”, përfshihet edhe detyrimi për të deklaruar [...] vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash, në llogari rrjedhëse [...] në datën 31 dhjetor të vitit paraardhës. Nën dritën e këtyre normave, në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash më 31 dhjetor 2006, prezumohet se nuk kishte të tillë [...].

[...] 33.13. Për rrjedhojë, duke i parë mospërputhjet e deklarimeve të subjektit ndër vite dhe në proces në tërësinë e tyre, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë provuar të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për shlyerjen e kredisë në maj 2007, për sa kohë që nuk rezultoi të ketë deklaruar kursime cash apo posedim të likuiditeteve cash në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006. Pretendimi i saj për cash-in e disponuar, mbeti në nivel deklarativ. Kjo analizë vjen në qasje me jurisprudencën e konsoliduar tashmë të Kolegjit, në lidhje me deklaratimet e kursimeve cash nga ana e subjekteve të rivlerësimit<sup>16</sup>[...].

19.8 Për sa më sipër, për kursimet e vitit 2005, rezultoi se, përkundër saktësisht (përfundimi i Komisionit), që subjekti ka bërë gjatë hetimit administrativ, ky deklarim i tij, përveçse nuk përputhet me konfirmimin nga \*\*\* Bank, sipas së cilës, në fund të vitit 2005, subjekti posedon kursime në shumën 165.356 lekë, nuk përputhet as me vetë deklarimin e subjektit në deklaratën në vijim DV-2006, në të cilin, ndër të tjera, deklaroi: kursime nga paga për vitin 2005, të depozituara pranë Bankës së Shqipërisë, shuma 400.000 lekë.

19.9 Vlerësohet se nuk mbështetet as saktësisht (përfundimi i Komisionit), i subjektit gjatë hetimit administrativ për kursimet e vitit 2006, pasi sikundër rezultoi nga deklarimi në DV-2006, shuma 400.000 lekë, investuar në bono thesari në emër të subjektit gjatë këtij viti, ka si burim kursimet e vitit të mëparshëm (2005). Rrjedhimisht, në vlerësimin e Komisionit Publik, për vitin 2006, krahas kursimeve të evidentuara në llogaritë bankare, duhet të konsiderohet si kursim dhe shuma 700.000 lekë, bazuar në deklarimin e subjektit në DV-2006.

19.10 Nisur nga mënyra e deklarimit të kursimeve në vitet 2003-2006, dhe vitet 2008 e në vijim, në vlerësimin e Komisionit Publik, i pambështetur gjendet dhe saktësisht (përfundimi i Komisionit), i subjektit për vitin 2007, vit për të cilin, shumës së kursyer në llogaritë bankare (llogaritë e pagave dhe llogarive pranë Bankës së Shqipërisë), duhet t'i shtohet dhe shuma e deklaruar e kursyer në masën 820.205 lekë.

19.11 Bazuar në sa më sipër argumentuar, duke lexuar dhe përlloritur kursimet e subjektit dhe personit të lidhur me të, sikundër janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të

---

<sup>15</sup> [73 Shihni, ndër të tjera, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit \*\*\*. \*\*\* [JR 19/201 ], vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit \*\*\*. \*\*\* [JR 33/2020], vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit \*\*\*. \*\*\* [JR 13/2021] etj.]

<sup>16</sup> [76 Shihni vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019, në prg. 31.]

ligjshme kursimet dhe shpenzimet e viteve 2005- 2007, për një diferencë negative në shumën -1.235.663 lekë<sup>17</sup>.

**20.** Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se: (i) pamjaftueshmëria e konstatuar si më sipër për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve deri në vitin 2007; (ii) pamjaftueshmëria e konstatuar në pagesën e këstit të parë të apartamentit me sip. 92.8 m<sup>2</sup> në vitin 2010, si rezultat i mosdeklarimit të posedimit në *cash* të shumës së tërhequr nga llogaria bono thesari, si dhe (iii) diferenca negative prej të paktën - 361.551 lekë, e konstatuar nga Komisioni për vitin 2016, janë të tilla që e bëjnë deklarin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

### **III. B. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale**

**21.** Nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit kushtetues, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, dhe për aq sa gjen zbatim, ligji nr. 96/2016, i ndryshuar, kanë rezultuar disa mangësi, të tilla që, për nga provueshmëria e tyre sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kanë kaluar si barrë prove subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të kundërtën.

**22.** Nga çështjet e shortuara për rivlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 43/2 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit nuk ka prodhuar akte e kërkuara në formularin e vetëdeklarimit, për këtë arsye janë analizuar tri dokumente ligjore jashtë kësaj periudhe, si dhe pesë dosje të përzgjedhura në mënyrë rastësore.

**23.** Komisioni, për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, si burim vlerësimi në këtë rast, rezulton se është ndalur më së shumti në hetimin dhe vlerësimin e të dhënave arkivore të KLP-së, informacionet e ardhura nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, si dhe denoncimet nga publiku, trajtuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

**24.** *Procedimi penal, i regjistruar në vitin 2014, në bazë të kallëzimit nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2014, të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, ndaj tre prokurorëve, midis të cilëve dhe subjektin e rivlerësimit, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.* Shtetasi \*\*\*. \*\*\* ka pretenduar, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit me pa të drejtë ka pushuar procedimin penal me nr. \*\*\* të vitit 2010, të inicuar mbi bazën e kallëzimit të tij për veprën penale të vjedhjes nëpërmjet mashtrimit, parashikuar nga neni 143 i K. Penal, ndërsa nga ana e gjykatave është urdhëruar vazhdimi i hetimeve, pasi ato kanë qenë të paplota dhe me mangësi. Për vlerësimin e këtyre pretendimeve, Komisioni ka administruar dosjen penale përkatëse, nga shqyrtimi i së cilës rezultojnë këto rrethana:

**24.1** Në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shtetasi \*\*\*. \*\*\*, në datën \*\*.1.2010, ka bërë kallëzim penal ndaj punonjësit të tij, \*\*\*. \*\*\*, për veprën penale të vjedhjes nëpërmjet mashtrimit. Mbi bazën e këtij kallëzimi, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar

---

<sup>17</sup> Në konsideratë të kursimeve të vitit 2005, në shumën 400.000 lekë jashtë sistemit bankar, diferenca negative rezulton - 88.893 lekë; Për vitin 2006, në konsideratë të kursimeve jashtë sistemit bankar në shumën 700.000 lekë, diferenca negative rezulton – 402.276 lekë; Për vitin 2007, në konsideratë të kursimeve jashtë sistemit bankar në shumën 820.205 lekë, diferenca negative rezulton – 744.494 lekë.

procedimin penal me nr. \*\*\*/2010, në datë\*\*2.2010, dhe, në përfundim të hetimeve të ndërmarra, në datën \*\*7.2010, ka vendosur pushimin e çështjes, duke arsyetuar se mungojnë elementet e veprës penale të mashtrimit, pasi përgjegjësia për shkaktimin e dëmit është një çështje juridiko-civile, që mund të zgjidhjet nga gjykata civile. Me marrjen dijani, kallëzuesi ka ankimuar vendimin e subjektit të rivlerësimit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*10.2011, ka shfuqizuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duke lënë detyrat përkatëse.

24.2 Çështja është regjistruar dhe ka rifilluar me qëllim përmbushjen e detyrave të lëna nga gjykata dhe subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës \*\* dhjetor 2012, ka vendosur sërish pushimin e çështjes. Kallëzuesi i është drejtuar sërish gjykatës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*5.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të organit të Prokurorisë dhe urdhërimin për vijimin e mëtejshëm të hetimeve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*12.2013.

24.3 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me konstatimin se hetimet e ndërmarra prej tij kanë qenë të paplota. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se shpjegimet e dhëna nga subjekti në raport me faktet e konstatuara, janë bindëse, pasi ka rezultuar se i kallëzuari është thirrur disa herë, por nuk është bërë e mundur gjetja e tij. Komisioni ka çmuar se në tërësi nuk ka pasur fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në cenimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

24.4 **Komisioneri Publik**, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. 574/2010, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 – 73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni. Në këtë kontekst, edhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit vlerësohen jo bindëse dhe të pamjaftueshme për të rrëzuar barrën e provës.

24.5 Nga aktet e administruara rezulton se hetimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të mangëta dhe jo të gjithanshme, konfirmuar ky fakt, dy herë nga kontrolli gjyqësor i hetimeve paraprake, duke i lënë detyra konkrete subjektit të rivlerësimit për të arritur më pas në një përfundim të drejtë për ecurinë e procedimit penal. Referuar fakteve dhe rrethanave të marra në vlerësim, procedimi penal nuk duket kompleks, e në këto kushte, vlerësohen të pajustificueshme vonesat e konstatuara në ndërmarrjen e hetimeve logjike dhe efektive në zgjidhjen e rastit. Kështu, në të dyja rastet e marrjes së vendimit të pushimit të procedimit penal nga ana e subjektit të rivlerësimit, gjatë harkut kohor shkurt 2010 – korrik 2010, e më pas, tetor 2011 – dhjetor 2012, subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka pasur detyra të qarta dhe konkrete të lëna nga gjykata në funksion të këtij procedimi, ato rezultojnë të papërmbushura. Shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit, i njëjtë me argumentin e përdorur në arsyetimin e vendimit për pushimin e çështjes në muajin dhjetor 2012, se i kallëzuari \*\*\*, \*\*\*, nuk gjendej, nuk duket bindës, pasi ky pretendim gjatë kontrollit gjyqësor të rastit është gjendur i pabazuar. Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*5.2013, ndër të tjera, arsyeton: “... *organi i akuzës nuk ka kryer veprimet hetimore që ligji ia ngarkon dhe nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara nga K. Pr. Penale. Është lënë detyrë me vendim gjyqësor që të thirret e të pyetet shtetasi \*\*\*. \*\*\*... Organi i akuzës duhet t’i kërkonte,*

*e tashmë t'i kërkojë sqarime organeve policore arsyet e mosnjoftimit të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të tij, në qoftë se ekzistojnë kushtet, pasi është identifikuar vendbanimi dhe gjendja civile e tij”.*

24.6 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se mangësitë e konstatuara në rastin e procedimit penal nr. \*\*\*/2010, së bashku dhe me mangësitë e konstatuara në dy denoncimet nga publiku, trajtuar në vijim nga një vlerësim tërësor të çështjes, ndikojnë në pozitën e subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, duke mos justifikuar kështu aplikimin e nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

**25. Denoncimi nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*.** Ky shtetas, duke pretenduar se është mashtruar dhe se ka pësuar humbje të shumave të konsiderueshme të parave, ka depozituar kallëzim penal ndaj shtetasit \*\*\*. \*\*\*, për veprën penale të mashtrimit, parashikuar nga neni 143 i K. Penal, kallëzim i ndjekur prej muajit prill 2018, nga subjekti i rivlerësimit. Për vlerësimin e këtij denoncimi, Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kopje të fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2018, nga shqyrtimi i së cilës, në mënyrë të përmbledhur, kanë rezultuar këto rrethana:

25.1 Fillimisht, kjo çështje është ndjekur nga një prokuror tjetër, i cili, më datë \*\* mars 2017, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kjo vendimmarrje është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2018, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve.

25.2 Më datë \*\*.4.2018 është regjistruar sërish çështja dhe rreth kësaj periudhe (pa datë të përcaktuar), me vendim të Drejtuesit të Prokurorisë është bërë zëvendësimi i prokurorit,<sup>18</sup> duke i kaluar kjo çështje subjektit të rivlerësimit. Ky i fundit, pasi ka administruar aktin “Relacion mbi përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*/2018”, përgatitur nga oficeri i policisë gjyqësore më datë \*\*.1.2019, me kërkesë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (pa datë të përcaktuar), ka kërkuar pushimin e çështjes.

25.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.5.2019, pasi ka analizuar faktin dhe veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimeve paraprake, i ka çmuar ato të paplota, pasi nuk janë respektuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2018, duke vendosur prishjen e vendimit për pushimin e procedimit penal dhe përmbushjen e detyrave të lëna brenda një afati tremujor, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2019. Më tej rezulton se, me vendimin e datës \*\*.3.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë, subjekti është zëvendësuar dhe kjo çështje i ka kaluar një prokurori tjetër.

25.4 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me konstatimin se: (i) Ka pasur zvarritje dhe mungesë të veprimeve hetimore të deleguara nga subjekti pranë OPGJ-së dhe (ii) Subjekti ka disponuar me vendim për pushimin e çështjes, duke mos zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara nga Gjykata e Apelit Tiranë, konkretisht, nga 12 dëshmitarë janë pyetur vetëm 6 prej tyre, nuk është kryer ballafaqimi i kallëzuesit me të kallëzuarën dhe nuk janë pyetur persona që kanë dijeni për rrethanat e çështjes. Në përfundim, ndër të tjera, Komisioni, pasi ka vlerësuar se shpjegimet

---

<sup>18</sup> Nga aktet e administruara rezultojnë se prokurori \*\*\*. \*\*\*, më datë \*\*.4.2018, ka paraqitur pranë Drejtuesit të Prokurorisë një “deklaratë/dhënie pëlqimi për zëvendësim prokurori”.

e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, *se moskryerja e veprimeve hetimore bazohet në bindjen e tij të brendshme*, nuk qëndron dhe janë të pabazuara, ka konstatuar se subjekti nuk ka respektuar urdhërimet e gjykatës. Megjithatë, Komisioni ka vlerësuar se, ndonëse janë konstatuar mangësi në veprimet hetimore të ndërmarra, kjo rrethanë është e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me aftësi profesionale nën nivelin minimal të kërkuar nga germa “c”, e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

**25.5 Komisioneri Publik**, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2018, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 – 73 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, edhe në këtë rast, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni. Mangësitë e vërejtura duken të natyrës përsëritëse në drejtim të ndërmarrjes së hetimeve logjike dhe efektive, si dhe në respektim të urdhërimeve të lëna nga gjykata. Në këtë kontekst, edhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit vlerësohen të pamjaftueshme për të rrëzuar barrën e provës.

**26. Denoncimi nga shtetasja \*\*\*. \*\*\*<sup>19</sup>**, lidhur me vendimin e mosfillimit të procedimit penal të subjektit të rivlerësimit për veprën penale të “*mashtimit*”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal. Komisioni ka administruar dosjen penale përkatëse, nga ku rezulton se shtetasja \*\*\*. \*\*\*, në materialin kallëzues me nr. \*\*\*/viti 2018, ka kallëzuar shtetasin \*\*\*. \*\*\* dhe \*\*\*. \*\*\*, duke pretenduar së është mashtuar prej tyre në lidhje me shitjen e një apartamenti.

26.1 Nga aktet e administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit, pas veprimit procedural të marrjes së dokumenteve, gjendur në fashikullin e kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2016, dhe verifikimeve të kryera ka vendosur *mosfillimin e procedimit penal*. Në vendimin e mosfillimit, subjekti i rivlerësimit përshkruan vendimmarrjen e një prokurori tjetër për kallëzimin penal me nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2016, arsyetimin që fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale, por është thelbi i një konflikti juridiko-civil, i cili mund të zgjidhet nga palët në rrugë gjyqësore, si dhe dijeninë e shtetasës \*\*\*. \*\*\* për këtë vendim më datë \*\*.4.2017, dhe mosankimin prej saj të këtij vendimi. Më tej, subjekti arsyeton se është në kushtet kur pretendimet e kallëzueses kanë qenë objekt hetimi dhe më parë, e për to është vendosur mosfillim i procedimit penal, sikurse evidentohet në vendimin e mosfillimit të datës \*\*\*.5.2016. Në këto kushte, subjekti ka vlerësuar se nuk mund të vendoset ndryshe në një kohë të mëvonshme kur organi procedues është i njëjti, pavarësisht emrit konkret të prokurorit të çështjes.

26.2 Ky vendim është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj. them., datë \*\*.5.2018, e cila ka konsideruar të gabuar arsyetimin e prokurorit për mosfillim të procedimit, duke urdhëruar kryerjen e hetimeve me detyra konkrete, ku ndër të tjera, konstaton se në rastin konkret kallëzimi është i ri, pasi lidhet me një banesë tjetër në raport me kallëzimin e mëparshëm. Në zbatim të vendimit gjyqësor, subjekti ka regjistruar procedimin penal me nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2018, dhe, në datën \*\*.6.2018, ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore. Në vijim, në datën \*\*.10.2018, subjekti ka sugjeruar bashkimin e çështjes me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2017, hetimet e të cilit janë drejtuar nga prokurorja \*\*\*. \*\*\* (me kallëzues \*\*\*. \*\*\* ndaj shtetasës \*\*\*. \*\*\*), nisur

---

<sup>19</sup> Regjistruar në Komision me nr. \*\*\* protokoli, datë \*\*.1.2019.

nga fakti se objekti i kallëzimit ishte i njëjtë për veprën penale të mashtrimit. Veprimet hetimore janë vazhduar më tej nga një tjetër prokuror.

26.3 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me konstatimin se prej tij nuk janë vazhduar hetimet në kundërshtim me vendimin e gjykatës, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore, si nga subjekti dhe nga oficeri i policisë gjyqësore, duke i kaluar barrën e provës. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegimet e tij në dokumentin: “*Parashtrime*”, të datës 17.11.2022<sup>20</sup>.

26.4 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me faktin e bashkimit të procedimeve penale, pasi subjekti është gjendur para kritereve ndaluese procedurale, ku nuk mund të kryheshin hetime paralele, bazuar në nenet 29 dhe 79 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur bashkimin e procedimeve, në rastin konkret, procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2018, me atë me nr. \*\*\*, të vitit 2017, procedim ky i regjistruar më parë për dy persona të marrë nën hetim, për veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, si dhe ishte kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”.

26.5 **Komisioneri Publik**, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2018, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 – 73 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni. Në këtë kontekst, edhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit vlerësohen jo bindëse dhe të pamjaftueshme për të rrëzuar barrën e provës.

26.6 Nga aktet e administruara në dosje, fillimisht, vërejmë se përfundimi i arritur nga Komisioni, *se prokurori Erion Pano ka vendosur bashkimin e procedimeve*, nuk i përgjigjet akteve në dosje, pasi ky vendim është marrë nga prokurorja \*\*\*. \*\*\* më datë \*\*.11.2018, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka përgatitur informacionin drejtuar drejtuesit të Prokurorisë më datë \*\*.10.2018. Rezulton se hetimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të mangëta dhe jo të gjithanshme, konfirmuar ky fakt nga kontrolli gjyqësor i hetimeve paraprake, vendimi gjyqësor nr. \*\*\* Rregj. Them, datë \*\*.5.2018, duke i lënë detyra konkrete subjektit të rivlerësimit për të arritur më pas në një përfundim të drejtë për ecurinë e procedimit penal. Gjithashtu vërehet se për rrethanat e ndodhura, nga një tjetër prokuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/viti 2017, në përfundim të të cilit është çuar kërkesa për gjykim i të kallëzuarve. Referuar fakteve dhe rrethanave të marra në vlerësim, procedimi penal nuk duket kompleks, e në këto kushte, vlerësohet i pajustificueshëm veprimi i mosfillimit të procedimit penal në mangësi të ndërmarrjes së hetimeve logjike dhe mungesës së efektivitetit në zgjidhjen e rastit. Shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit janë të paplota, pasi nuk arsyetojnë lidhur me vendimin e mosfillimit të procedimit penal, por nisin kronologjinë pas vendimit gjyqësor nr. \*\*\* Rregj. Them, datë \*\*.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* Regj. Themel., datë \*\*.5.2018, ndër të tjera, arsyeton: “... *Prokurori ka gabuar me arsyetimin, meqenëse kallëzimi i bërë nga kallëzuesja \*\*\* \*\*\*, i regjistruar si i tillë*

---

<sup>20</sup> Për më tepër, shihni f. 23- 25, të tij.



me nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2016, është vendosur mosfillimi dhe kallëzuesja nuk e ka ankimuar këtë vendim, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një kallëzim të ri, për një banesë tjetër në raport me kallëzimin. Prokurori duhet të kryejë hetim në drejtim të revokimit të kontratës së sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2013 dhe të pyetet \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, për të përcaktuar veprimet noteriale për kalimin e pronësisë së apartamentit, përcaktuar në këtë kontratë sipërmarrje”.

**27.** Duke përfunduar për sa më sipër, bazuar në indikatorët vlerësues, të parashikuar nga nenet 71-73 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për subjektin e rivlerësimit konstatohen disa raste me mangësi, të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe prova. Mangësitë e konstatuara në këtë kriter vlerësimi duhen vlerësuar së bashku dhe me problematikat e vërejtura në kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm me atë të arritur nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**28.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**29.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**30.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Erion Pano.

### **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**